LIGJ
Nr.9266, datë 29.7. 2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT "MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE TË TIRANËS""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për realizimin e programit "Menaxhimi i mbetjeve urbane të Tiranës"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4304, datë 23.8.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT "MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE TË TIRANËS"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit (MRRTT) dhe Qeveria e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimit për Zhvillim (MAE-DGCS),

më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese",

duke qenë se në protokollin e bashkëpunimit për trevjeçarin 2002 – 2004, i nënshkruar më 9 prill 2002, Kooperacioni Italian impenjohet në financimin e një iniciative për fuqizimin e sistemit të menaxhimit dhe mbledhjes së mbetjeve të ngurta të Bashkisë së Tiranës, duke dhënë për këtë qëllim një kredi ndihme deri në 6 000 000 euro dhe një grant prej 400 000 euro;

duke qenë se gjatë mbledhjes më datë 29.7.2003, Komiteti Drejtues i MAE/DGCS ka miratuar iniciativën "Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës", i quajtur në vijim "Programi", duke miratuar për këtë qëllim dhënien e një kredie ndihme prej 6 000 000 euro dhe një grant prej 400 000 euro, për të konkretizuar të gjitha aktivitetet e projektimit realizimit dhe të monitorimit;

duke marrë në konsideratë sa më lart,

Palët Kontraktuese ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Qëllimi dhe pjesët e Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë detyrimet reciproke të të dyja Palëve për

zbatimin korrekt të programit, me referim të veçantë ndaj modaliteteve të vlerësimit të kontratave, si dhe atyre të menaxhimit, të përgjegjësisë, të shpërndarjes së fondeve të kredisë së ndihmës.

Kjo Marrëveshje është e përbërë nga 14 nene dhe nga 3 shtojcat bashkëngjitur, që janë pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje:

1. Sinteza e programit
2. Sipërmarrja e shërbimeve, e livrimeve dhe e punimeve (kushte të veçanta-specifikimet)
3. Modalitetet e zbatimit dhe menaxhimit të kredisë së ndihmës.

Neni 2

Objektivat e programit

Objektivi i përgjithshëm i programit është reduktimi i rrezikut mjedisor dhe shëndetësor, që mund të rrjedhë nga administrimi i papërshtatshëm i sistemit të mbledhjes dhe asgjësimit të mbetjeve të ngurta në rajonin e Tiranës, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës të popullatës vendase.

Objektivat specifikë janë:

- Rritja e sigurisë në pikën e shkarkimit të mbeturinave në Sharrë, duke reduktuar në mënyrë drastike ndotjen e zonës dhe duke e kthyer atë, në një zonë me akses të mirë në çdo stinë;
- Fuqizimi i sistemit të mbledhjes e transportit të mbetjeve të ngurta urbane në zonat periferike;
- Fuqizimi i kapaciteteve menaxhuese, teknike dhe organizative të personelit të caktuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane, si dhe përgatitja e një grupi rregulloresh rajonale dhe kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane dhe për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 3

Përshkrimi i programit

Programi është përshkruar shkurtimisht në shtojcën 1 dhe parashikon të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Transformim të pikës së shkarkimit në Sharrë në një pikë shkarkimi moderne të kontrolluar, me rrjet drenazhimi për llumin e mbetjeve dhe rrjet për mbledhjen e biogazit, me akses në të gjitha stinët dhe në gjendje për asgjësimin e mbetjeve të ngurta urbane të rajonit të Tiranës, me siguri të plotë, për të paktën 5/6 vjet;
- Sistem për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve të ngurta urbane në zonat periferike (në kompetencë të ndërmarrjes bashkiake) e fuqizuar në mënyrë të përshtatshme, me furnizim kasonetash dhe mjetesh transporti;
- Kapacitete menaxhuese, teknike dhe organizative të personelit të caktuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në përshtatje me punën që do të kryhet;
- Grup rregulloresh rajonale dhe kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane dhe për mbrojtjen e mjedisit, që do të bëhet e disponueshme për Bashkinë dhe për organizma të tjerë kompetentë në këtë fushë (MRRTT dhe MM).

Zbatimi i programit përmban:

- Aktivitetet e projektimit, monitorimit, si dhe punime emergjente që do të kryhen me financimin grant në pikën e shkarkimit të Sharrës;
- Ndërhyrje kryesore, që do të përbëhen nga punime, livrime dhe asistencë teknike, që do të realizohet me financimin nëpërmjet kredisë së ndihmës dhe që do të jepet nëpërmjet procedurave të tenderimit të rezervuara vetëm për shoqëritë italiane.

Neni 4

Institucionet e përfshira në realizimin e programit

Institucionet e përfshira në realizimin e programit janë si më poshtë:

Për palën shqiptare:

a) MRRTT, që do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja në fjalë, duke përfshirë strukturat e tjera kompetente shqiptare, në veçanti Bashkinë e Tiranës dhe Ministrinë e

Mjedisit (MM);

b) Ministria e Financave (MF), që do të hartojë Konventën financiare me MCC-në dhe do të ndjekë kontaktet operative me këtë të fundit e me bankat vepruese, siç përcaktohet në Konventën financiare;

c) PIU pranë MRRTT-së, që do të mbikëqyrë projektet tashmë të aprovuara "Shërbimet esenciale Tiranë–Vlorë" dhe "Periferitë e Tiranës–komponent infrastrukturor", do të sigurojë koordinimin e të gjitha funksioneve të nevojshme me natyrë teknike dhe menaxheriale për realizimin e programit.

Për palën italiane:

a) MAE/DGCS që do të sigurojë shpërndarjen e burimeve financiare për kredinë, sipas modaliteteve të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane në fuqi, të treguara përmbledhtazi në këtë Marrëveshje. MAE/DGCS në bashkëpunim me Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, do të ketë, përveç të tjerash, detyrën e monitorimit të ecurisë së programit dhe kapacitetin e tij, për të arritur rezultatet e paraqitura në nenin 3. MAE/DGCS do të veprojë nëpërmjet zyrave kompetente për zbatimin e detyrave të saj. Në veçanti, Njësia Teknike Qendrore e MAE/DGCS, më poshtë e quajtur NJTQ do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike për mbështetjen e realizimit të programit.

b) Mediocredito centrale (MCC), e cila–sipas instruksioneve të MAE/DGCS dhe Ministrisë së Ekonomisë Italiane–do të hartojë me Ministrinë e Financave të Shqipërisë një Konventë financiare, që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës. Në kuadër të kësaj Konvente financiare, MCC-ja do të ndjekë zbatimin e kontratave të veçanta për livrimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, nëpërmjet të cilave do të realizohen aktivitetet e parashikuara në program. Përveç të tjerash do të jetë në kujdes të MCC-së që të sigurojë pagesën e kontratave respektive për organizmat zbatuese.

c) Ambasada/UTL në Tiranë, që do të sigurojë të gjitha funksionet e nevojshme me natyrë teknike për mbikëqyrjen korrekte të ecurisë së aktiviteteve. Në kuadër të aktiviteteve institucionale, Ambasada/UTL do të sigurojë, përveç të tjerash, edhe kontaktet e nevojshme mes palëve të programit, duke ndjekur edhe marrjen e përcjelljen e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Neni 5

Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit janë si më poshtë:

1. Kredi ndihme në shumën 6 000 000 euro për realizimin e ndërhyrjes kryesore, që përbëhet nga punime për sistemimin e pikës së shkarkimit të Sharrës, furnizime dhe asistencë teknike;

2. Granti prej 400 000 euro për aktivitetet e projektimeve të ndërhyrjes kryesore, monitorimit, si dhe punimeve urgjente në pikën e shkarkimit të Sharrës;

3. Fondet e Qeverisë shqiptare, të barasvlefshme me rreth 1 200 000 euro për kostot lokale (TVSh-në, taksat doganore dhe shpronësimet).

Afatet dhe kushtet e kredisë së ndihmës janë si më poshtë:

- Periudha e rimbursimit të kredisë	38 vjet
- Periudha e faljes (për rimbursimin e kredisë)	17 vjet
- Taksa vjetore e interesit	0,10 %

Në bazë të procedurave në fuqi, MAE/DGCS, hapat kryesore, që duhen ndërmarrë për përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës, janë si më poshtë (të specifikuara më mirë në shtojcën 3):

1. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje;

2. Nxjerrja nga ana e Ministrisë së Ekonomisë Italiane të një dekreti ministror që autorizon MCC-në, për të negociuar dhe nënshkruar Konventën financiare me MF-në;

3. Hartimi i Konventës financiare ndërmjet MCC dhe MF-së;

4. Përgatitja e dokumenteve të tenderit për zbatim të aktiviteteve të parashikuara në program (punime, livrime pajisjesh dhe asistencë teknike);

5. Zhvillimi i tenderit dhe shqyrtimi i ofertave përkatëse nga ana e komisionit të vlerësimit të krijuar nga MRRTT-ja për dhënien e kontratës;

6. Verifikimi i konformitetit nga ana e MAE-DGCS të procedurave të ndjekura të tenderit dhe i llojit të kontratës që duhet lidhur dhe në rastin e një përfundimi pozitivisht, lidhja e kontratës nga ana

e MRRTT-së;

7. Përgjegjësia e kontratës në Konventën financiare, me modalitetet e livrimit të fondeve të dhëna në shtojcën 3.

Neni 6

Monitorimi i programit

Ecuria e programit do të monitorohet gjatë gjithë kohës nga MAE/DGCS (nëpërmjet misioneve periodike të funksionarëve dhe ekspertëve të përcaktuar të fushës) dhe nga MRRTT. Palët kontraktuese do të angazhohen të përcaktojnë që tani të gjitha masat, që do të konsiderohen të nevojshme të ndërmerren gjatë zbatimit të programit, në rast se nuk është respektuar skema e treguesve ose nëse ajo konsiderohet e papërshtatshme për kushtet sektoriale dhe lokale.

Neni 7

Modalitetet e marrjes së shërbimeve, livrimeve dhe punimeve

Përcaktimi i zbatuesve të aktiviteteve të programit do të kryhet përmes zhvillimit të tenderave të disiplinuar sipas dispozitave të përfshira në manualin e procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian, më 23 dhjetor 2002), lidhur me:

"Tenderat e shërbimeve, livrimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta" dhe siç është saktësuar në shtojcën 2.

Neni 8

Detyrimet e Qeverisë italiane

Qeveria italiane angazhohet të garantojë financimet e mëposhtme:

- Deri në 6 000 000 euro kredi ndihme, që do të bëhet i disponueshëm nëpërmjet MCC-së dhe do të jepet siç është përcaktuar në shtojcën 3;
- Deri në 400 000 euro në formë grant, që do të menaxhohet direkt nga MAE/DGCS dhe nga ambasada italiane në Tiranë.

Neni 9

Detyrimet e Qeverisë shqiptare

Qeveria shqiptare angazhohet:

- Të vërë në dispozicion burimet financiare përkatëse, të barasvlefshme me 1 200 000 euro;
- Të ndërmarrë të gjitha veprimet, aktivitetet dhe aktet formale të domosdoshme për një zbatim me sukses të programit;
- Të bashkëpunojë me MAE/DGCS për aktivitetin e monitorimit të programit, në bazë të nenit 6, si dhe për akses në dokumentacionin ekzistues e në zonat e aktiviteteve.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje e lindur ndërmjet Palëve Kontraktuese, lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Marrëveshjes aktuale, do të zgjidhet, për sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 11

Pengesa dhe forca madhore

Në rast pengimi të realizimit të programit, për shkak të forcave madhore (luftë, përmbytje, zjarr, tufan, tërmet, konflikte pune, greva, masa të qeverive respektive, vështirësi të paparashikuara gjatë transportit dhe shkaqe të tjera) të njohura si të tilla nga të dyja palët ose në rast rreziku, ose kushte të rrezikshme për personelin e huaj, do të zbatohen dispozitat në vazhdim, të bazuara në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të miratuara nga MAE/DGCS:

a) Në rast se kohëzgjatja e pengimit të realizimit të programit është më pak se 6 (gjashtë) muaj, përdorimi i fondeve të papërdorura do të pezullohet derisa MAE/DGCS do të autorizojë rifillimin e aktiviteteve;

b) Në rast se kohëzgjatja e pengesës është më shumë se 6 (gjashtë) muaj dhe më pak se 24 (njëzet e katër) muaj, programi pezullohet dhe fondet e papërdorura do të mbahen derisa të mos ketë më pengesa dhe të merret autorizimi i MAE/DGCS për fillimin e punimeve;

c) Në rast se kohëzgjatja e pengesës është më e madhe se 24 (njëzet e katër) muaj, palët janë të detyruara të bien dakord mbi vazhdimësinë e programit dhe të përcaktojnë ecurinë e veprimeve. Në rast se është i pamundur vazhdimi i aktivitetit, Palët duhet të vendosin për destinacionin e fondeve të papërdorura.

Neni 12

E drejta e zgjidhjes së Marrëveshjes së MAE/DGCS

MAE/DGCS ruan të drejtën e tërheqjes nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

a) Mosrealizim i aktiviteteve të parashikuara në program, për arsye që nuk i atribuohen palës italiane;

b) Pengesa të vazhdueshme ose forca madhore në bazë të nenit 11 të mësipërm.

Në të dyja rastet e përmendura më lart, MAE/DGCS mund të vendosë njëanshmërisht mbi përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar dhe MRRTT-në nëpërmjet një note verbale të paktën 3 (tre) muaj përpara. Për çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MRRTT-ja duhet të ndërpresë aktivitetet e programit, përveç kur Palët bien dakord ndryshe.

Neni 13

Modifikime

Palët Kontraktore në çdo moment mund të propozojnë modifikime të përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje me anë të shkëmbimit të notave verbale, nëpërmjet rrugëve diplomatike. Modifikimet e kryera sipas procedurës së mësipërme do të hyjnë në fuqi me anë të të njëjtave procedura, që parashikohen në këtë Marrëveshje për hyrjen e saj në fuqi.

Neni 14

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy të tillë, me të cilët Palët Kontraktuese do të njoftohen zyrtarisht mbi zhvillimin e procedurave të brendshme përkatëse, të parashikuara për këtë qëllim.

Kjo Marrëveshje do të ketë një kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe do të rinovohet automatikisht për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

Kjo Marrëveshje mund të denoncohet në çdo kohë dhe denoncimi do të ketë efekt vetëm 6 (gjashtë) muaj mbas njoftimit të tij Palës tjetër Kontraktuese.

Në bazë të sa më sipër, përfaqësuesit nënshkrues, të autorizuar nga qeveritë përkatëse, firmosën këtë Marrëveshje.

Hartuar në Tiranë, më _____ në dy origjinale, secili në gjuhët italiane dhe shqipe. Në rast mospërputhjeje të interpretimit, do të ketë përparësi teksti në gjuhën italiane.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ZV/Ministri i Rregullimit të Territorit e Turizmit Arben Demeti	PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË ITALISË Ambasadori i Italisë në Tiranë Attilio Massimo Iannucci

SHTOJCË 1

Sintezë e programit

OBJEKTIVAT

Objektivi i përgjithshëm i projektit është reduktimi i rrezikut mjedisor dhe atij shëndetësor që vjen si rezultat i administrimit të papërshtatshëm të sistemit të mbledhjes dhe asgjësimit të mbetjeve të ngurta të rajonit të Tiranës, duke kontribuar në një përmirësim të cilësisë së jetës të popullatës.

Objektivat specifikë janë:

- Sigurimi i pikës së shkarkimit të mbetjeve në Sharrë, duke e transformuar atë në një pikë shkarkimi të kontrolluar sipas standardeve europiane;
- Fuqizimi i sistemit të mbledhjes dhe të transportit të mbetjeve të ngurta urbane në zonat periferike të Bashkisë;
- Përforcimi i kapacitetit menaxhues, teknik dhe organizativ i personelit të caktuar për trajtimin e mbetjeve të ngurta urbane;
- Përgatitja dhe përshtatja e një grupi rregullash rajonale dhe kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane dhe për mbrojtjen e mjedisit.

REZULTATET E PRITSHME

Me aktivitetet e parashikuara në projekt, parashikohet arritja e rezultateve të mëposhtme:

- Transformimi i pikës së shkarkimit të Sharrës në një pikë moderne shkarkimi të kontrolluar, me një rrjet drenazhimi të llumit të mbeturinave, rrjet për mbledhjen e biogazit, me akses të njëjtë në të gjitha stinët dhe në gjendje të asgjësojë mbetjet e ngurta urbane në rajonin e Tiranës, me siguri të plotë, për të paktën 5/6 vjet. Pikë shkarkimi e pajisur me mjete mekanike të nevojshme për sistemimin dhe mbulimin e mbetjeve të ngurta urbane, si dhe me personel të trajnuar për këtë qëllim;
- Sistem mbledhjeje dhe transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në zonat periferike (në kompetencë të bashkisë) i fuqizuar në mënyrë të përshtatshme, me pajisje të kasonetave dhe mjete transporti;
- Kapacitete menaxhuese, teknike dhe organizative të personelit të caktuar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane në mënyrë të përshtatshme me detyrën që do të përmbushin;
- Grup rregullash rajonale dhe kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe të mbrojtjes së mjedisit, i vënë në dispozicion të bashkisë dhe organizmave të tjerë kompetentë në këtë fushë (MRRTT dhe MM).

AKTIVITETET E PARASHIKUARA

Aktivitetet do të përmblidhen në dy faza të lidhura, në përputhje me prioritetet e identifikuara dhe llojin e financimit, si më poshtë:

1. Një fazë e parë (grant 400 000 euro), që përfshin punime emergjente për ta bërë aktive pikën e shkarkimit dhe të rregullojë situatën aktuale kritike, si dhe veprime parapërgatitore (projektim, përgatitje specifike) për të bërë të mundur më pas ndërhyrjen kryesore të financuar nga kredia e ndihmës.
2. Një fazë e dytë (projekt i financuar nga kredia e ndihmës prej 6 milionë euro), parashikon: (i) ndërhyrje infrastrukturore dhe furnizim me pajisje, për t'i dhënë siguri pikës së shkarkimit të Sharrës, (ii) livrime pajisjesh për të fuqizuar sistemin e mbledhjes së mbetjeve të ngurta urbane në zonat periferike dhe (iii) sigurimi i shërbimeve të specializuara për të përforcuar kuadrin menaxhues, organizativ dhe normativ.

Aktivitetet e fazës së parë kanë të bëjnë me:

a) punimet urgjente të sistemimit të frontit aktual të mbetjeve dhe riorganizimin provizor të sistemit të kultivimit, me qëllim që të mundësojnë mbarëvajtjen e pikës së shkarkimit gjatë kohës së fillimit të ndërhyrjes së financuar nga kredia e ndihmës. Punimet konsistojnë në sistemimin e zonës së hyrjes, presimin e mbetjeve dhe në mbulimin e këtyre të fundit me dhe për mbushje.

b) projektimin paraprak për aktivitetet e parashikuara në ndërhyrjen e financuar nga kredia e ndihmës (projekt tip, specifikimet për pajisjet dhe për shërbimet, kushtet e tenderimit);

c) fillimin e zbatimit, në përputhje me përpunimin e projektit parapërgatitor të pikës së shkarkimit;

d) aktivitetin e monitorimit periodik.

Aktivitetet e fazës së dytë kanë lidhje me:

a) Vendosjen në siguri dhe menaxhimin e pikës së shkarkimit me aktivitetet:

- sistemim progresiv i gropave të mbetjeve të ngurta urbane të grumbulluara.
- kompaktëzim i vazhdueshëm i mbetjeve dhe mbulimi i gropave me dhe për mbushje.
- furnizim me pajisje të përshtatshme për veprimet e lartpërmendura, më konkretisht: rrul ngjeshës, ruspa me kavo, ekskavator me zinxhirë, lopata gome e automjete vetëshkarkuese për transportin e inerteve për mbulim.

b) Fuqizimin e sistemit të mbledhjes dhe transferimit të mbetjeve të ngurta urbane për shoqërinë komunale "Quarters Cleaning Enterprice" (që merret me mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane në zonat periferike dhe në tregjet rajonale), me livrime pajisjesh si: kasoneta me kapacitet 3.200 lt, sipas standardeve europiane, automjete me autokompresor me ngarkim anësor dhe automjet për larjen e kasonetave.

c) Programin e asistencës teknike për institucionet, me aktivitetet e mëposhtme:

- Zhvillimi i një sistemi informativ, i bazuar në teknologjinë GIS, si mbështetje për pozicionimin e kontenitorëve të mbledhjes, për të lehtësuar lëvizjen e automjeteve të mbledhjes dhe të transferimit, për identifikimin dhe lokalizimin e stacioneve të transferimit, si dhe për menaxhimin operativ dhe administrativ të sistemit (p.sh.: regjistrat për ngarkimin dhe shkarkimin e mbetjeve, inventare për inventarizim të veglave të punës, regjistër i përfituesve, faturim).
- Rishikimi i procedurave administrative për përgatitjen e bilancit të ushtrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane.
- Përpunimi dhe fillimi e një studimi specifik për përshtatjen e sistemit të taksimit të përfituesve nga shërbimi mbi mbetjet e ngurta urbane.
- Përpunim i metodologjive teknike të menaxhimit të shërbimit të ri të menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane (manual i drejtimit të shkarkimit dhe procedura operative për sistemin e mbledhjes).
- Formim teorik dhe trajnim operativ i drejtuesve, kuadrove, nëpunësve dhe të punëtorëve të Bashkisë së Tiranës, të angazhuar në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane.
- Asistencë teknike dhe trajnim "*on the job*" i personelit të bashkisë për menaxhimin e pikës së shkarkimit për një kohëzgjatje prej 2 vjetësh.

- Kryerja e fushatave të sensibilizimit dhe informimit publik mbi menaxhimin korrekt dhe efikas të mbetjeve të ngurta urbane.
- Përpunimi, brenda legjislacionit kombëtar të sektorit–në koordinim me Ministrinë e Mjedisit – i një plani për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ngurta urbane në nivel rajonal dhe kombëtar.

Vlerësim tregues i kostove të përgjithshme të projektit (të mbuluara nga kredia e ndihmës)

Zëri	Vlera euro
Punime infrastrukturore për vënien në siguri dhe zgjerimin e pikës së shkarkimit	2 291 000
Furnizim me makineri për menaxhimin e pikës së shkarkimit	1 443 000
Furnizim me makineri dhe pajisje për mbledhjen dhe transportimin e mbetjeve të ngurta urbane	1 192 000
Shërbime të asistencës teknike dhe trajnuese për Bashkinë dhe ente të tjera të përfshira në projekt	1 074 000
Totali	6 000 000

SHTOJCA 2

SIPËRMARRJA E SHËRBIMEVE, FURNIZIMEVE DHE PUNIMEVE (KUSHTE TË VEÇANTA)

Kjo shtojcë i referohet përdorimit të kredisë së ndihmës italiane.

Dhënia e kontratave do të kryhet nëpërmjet tenderave të hapur, të rezervuar vetëm për shoqëritë italiane. Përqindja e kredisë së ndihmës e përdorshme për kosto lokale dhe/ose për vende në

zhvillim, nuk mund të kalojë 30% të vetë kredisë.

Për dhënien e të gjitha sipërmarrjeve të parashikuara në program, do të zbatohen procedurat e parashikuara në manualin e procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002) lidhur me: Sipërmarrjet e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve, në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Në çdo rast, procedura e seleksionimit duhet të përfshijë:

1. Verifikimin e përshtatshmërisë së ofertave (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje), që nuk do të quheshin të përshtatshëm, nëse:

a) janë në gjendje falimentimi, likuidimi, administrim i kontrolluar ose me preventiv të konkorduar, ndërprerje aktiviteti ose që janë objekt i një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe rregullat vendase;

b) janë objekt i një procedure për deklarim falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar, preventiv i konkorduar ose të një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe rregullat vendase;

c) janë dënuar me vendim të formës së prerë pa të drejtë apelimi, për shkelje të etikës profesionale;

d) janë deklaruar përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave profesionale, të provuara me çfarëdolloj elementi dokumentacion nga administrata vlerësuese;

e) nuk janë në rregull me detyrimin e derdhjes së kontributeve shoqërore sipas dispozitave ligjore të vendit, ku janë permanentë;

f) nuk janë në rregull me detyrimin e derdhjes së taksave, sipas dispozitave ligjore të vendit, ku janë permanentë;

g) janë shpallur fajtorë për pasaktësi të rënda në dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata vlerësuese për sa më sipër;

h) janë shpallur fajtorë, për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, të mospërmbushjeve të rënda në lëndën e zbatimit, në kuadër të një kontrate tjetër të nënshkruar me të njëjtën administratë vlerësuese ose në kuadër të një kontrate tjetër të financuar nëpërmjet fondeve komunitare.

Përveç kësaj, ofertuesit italianë do të jenë të detyruar të paraqesin një vërtetim ose një deklaratë të barasvlefshme me të, që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e treguara në Dekretin Legjislativ Italian të datës 8.8.1994, n.490 (“antimafia”).

Ofertuesit duhet të paraqesin, në mbështetje të ofertave të tyre, provat e zakonshme, konform legjislacionit të vendit ku janë permanent, që vërtetojnë se ata nuk janë ndodhur në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat (a), (b), (c), (e) dhe (f).

2. Verifikimin e gjendjes ekonomike dhe financiare të ofertuesve, nëpërmjet:

a) Një deklarate të kapitalit social të shoqërisë dhe xhiros, në tre vitet e fundit gjatë tenderimeve;

b) Një deklarate të xhiros totale të konkurruesve, në rast të një *joint venture* të përkohshme, të xhiros të secilit prej pjesëmarrësve.

c) Një deklarate, që tregon xhiron e sektorëve të veçantë, të cilëve u referohet dhe tenderi, ose sektorin për të cilin, në rast të një asocimi të përkohshëm, shoqëria individuale synon të kontribuojë;

d) Një deklarate të përshtatshme të përfaqësuesve ligjorë ose të një certifikate bankare që përmban informacion mbi marrëdhëniet me institucionet bankare me rëndësi ndërkombëtare për të demonstruar pranueshmërinë komerciale dhe financiare të konkurruesve të shoqërive që përbëjnë asocimin e përkohshëm;

e) Një kopje certifikate që vërteton se konkurruesi është anëtar i Dhomës së Tregtisë në vendin, ku është permanent;

f) Në rast të një asocimi të përkohshëm, duhet të paraqitet një kopje e kontratës së asocimit, që tregon shoqërinë që merr përsipër rolin e palës përgjegjëse përkundrejt MIE për zbatimin e kontratës.

3. Verifikimin e kapacitetit teknik dhe profesional të konkurruesve, nëpërmjet:

a) Kopjeve dokumentesh origjinale që vërtetojnë përbërjen ligjore dhe/ose statusin ligjor, dhe që përcaktojnë vendin e regjistrimit dhe/ose selinë qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe, nëse këto të dhëna nuk përputhen, vendndodhjen e selisë qendrore të kompanisë, shoqërisë, partneritetit, ose të pjesëve të ndryshme që përbëjnë konkurruesit, në rast të një *joint venture* të përkohshme;

b) Një raport që përmban informacione të dokumentuara mbi eksperiencat e mëparshme të

punës së konkurruesve ose shoqërisë së përkohshme në tender me natyrë të njëjtë në tre vitet e fundit, dhe lidhur me tenderat e tjera në proces, me informacione specifike rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkrete në çdo tender;

c) Kualifikimeve dhe eksperiencës së anëtarëve kyç të stafit, që do të ngarkohen nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës; një raport i shkurtër mbi aktivitetin e konkurrentëve, të vetëm apo të asociuar, që u referohet veçanërisht aktiviteteve të lidhura me programin.

Krahasimi midis konkurrentëve, mbi bazën e kritereve të vlerësimit të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, do të kryhet duke përdorur kriteret e përcaktuara dhe çmimin për identifikimin e konkurrentit ekonomikisht më të favorizuar.

Kriteret duhet të jenë të sakta, jodiskriminuese dhe as paragjykuese për një konkurrim korrekt.

SHTOJCA 3

MODALITETI I ZBATIMIT DHE I LIVRIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

SEKSIONI I
NXJERRJA E SHPALLJES SË TENDERIT, PROCEDURA ZBATUESE

Dokumentacioni duhet të përgatitet konform shtojcës 2, që përmend manualin e procedurave (i përshtatur nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002), lidhur me: Kontratat e shërbimeve, furnizimeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta. Dokumentacioni në çdo rast duhet:

- të specifikojë “kushtet e veçanta” në lidhje me çdo tender;
- të sqarojë kriteret e vlerësimit që do të ndjekë komisioni i krijuar në MRRTT.

1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

Dokumentet e tenderit për realizimin e ndërhyrjes me anë të kredisë së ndihmës (punime, furnizime me pajisje dhe asistencë teknike) do të jenë nën përgjegjësi të ambasadës italiane/UTL (duke përdorur fondin grant) dhe më pas do t’i jepet MRRTT-së për verifikimin nën kompetencë të palës shqiptare.

Dokumentet e tenderit të verifikuara dhe/ose të integruara nga MRRTT-ja, së bashku me kërkesën për publikimin e shpalljeve në gazetat italiane do t’i dërgohen më pas Ambasadës Italiane/UTL nga PIU pranë MRRTT-së.

2. Verifikimi i konformitetit të dokumentacionit të tenderit.

Verifikimi i konformitetit me marrëveshjen aktuale do të kryhet nga MAE/DGCS në bazë të përputhjes së:

- Dokumentacionit ligjor me procedurat e treguara në shtojcën 2;
- Specifikimeve teknike dhe parametrave të vlerësimit me objektivat, që pritet të arrijë programi.

3. Publikimi i shpalljes

Në rast të një rezultati pozitiv të verifikimit, shpallja do të publikohet nga ana e MAE/DGCS në gazetat italiane, në Buletinin e Kooperacionit dhe në Web-site e MAE. MRRTT-ja do të procedojë njëkohësisht me publikimin e shpalljes në gazetat kombëtare.

SEKSIONI II
FAZA E VLERËSIMIT – PROCEDURA E ZBATUAR

1. Shqyrtimi i ofertave të dorëzuara për çdo tender do të kryhet nga një komision vlerësimi i krijuar për këtë qëllim nga MRRTT-ja. PIU pranë MRRTT-së do të ndjekë ecurinë e tenderit, duke asistuar – nëse është e nevojshme - edhe Komisionin. Në çdo rast, në mbledhjet e komisionit nuk mund të marrë pjesë personeli italian që vepron pranë ambasadës italiane/UTL ose i dërguar me mision nga DGCS.

2. PIU do t'i transmetojë ambasadës italiane/UTL dokumentacionin që përmban aktet e komisionit, së bashku me kontratën që do të lidhet, duke kërkuar miratimin për lidhjen e kontratës. Ky dokumentacion do t'i përcillet MAE/DGCS nga ambasada italiane/UTL së bashku me komentet e mundshme.

3. MAE/DGCS do të verifikojë parimisht përputhjen ligjore dhe teknike të vlerësimeve të kryera me procedurat dhe kriteret/parametrat e parashikuar në kushtet e tenderit. Me tu kryer verifikimet, MAE/DGCS do të informojë PIU, nëpërmjet ambasadës për rezultatin e verifikimit.

4. Në rast të një përfundimi pozitiv (nulla osta) MRRTT do të procedojë me lidhjen e kontratës me shoqërinë, e rezultuar fituese.

SEKSIONI III
FAZA E PAJTUESHMËRISË SË KONTRATATËS DHE SHPËRNDARJES SË FONDIT – PROCEDURA E APLIKUAR

1. Kontrata e lidhur midis kompanisë fituese dhe MRRTT-së duhet t'i jepet MAE/DGCS nëpërmjet ambasadës italiane/UTL, bashkëngjitur kopjes së Performance bond dhe deklaratën e angazhimit të palës shqiptare për të përballuar kostot lokale (TVSH, taksat doganore, shpronësimet, etj.).

2. Mbas marrjes dhe kontrollit të dokumentacionit, MAE/DGCS do të autorizojë Mediocredito Centrale për hartimin e kontratës në pajtim me Konventën financiare.

3. Mediocredito Centrale do t'i kërkojë shoqërisë italiane të interesuar një "deklaratë angazhimi" që të gjitha mallrat dhe shërbimet do të jenë me origjinë italiane dhe që shpenzimet lidhur me projektin, që mund të bëhen në vend dhe/ose në vendet e treta të industrializuara nuk do të mund të kalojnë 30% të vlerës kontraktuale, si dhe një certifikatë antimafie. Njëkohësisht, Mediocredito Centrale do t'i kërkojë kredimarrësit shqiptar paraqitjen e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve, si dhe udhëzimet për bankën vepruese.

4. Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit përcaktuar në pikën 3, Mediocredito Centrale do t'i komunikojë kredimarrësit, Bankës Agjente Italiane si dhe PIU-t pranë MRRTT-së, pajtimin e kontratës me Konventën financiare, si dhe mënyrën e financimit. Përfundimi i kësaj procedure do të lejojë dhënien e "parapagesës", parashikuar kjo në kontratë, si dhe do të përcaktojë datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

5. Për sa u përket pagesave të tjera, ato do të vihen në dispozicion vetëm pas miratimit nga ana e MRRTT-së të shërbimeve të parashikuara në kontratë.